

Intervista e fundvitit me Kreshnik Berishën

■ NË KËTË NUMËR

Intervista e fundvitit me Kreshnik Berishën	2
Mileniumi i ri mban një trajnim për gazetari	2
ATRC-ja organizon një diskutim publik mbi ndotjen e ujit të pijshëm	3
Trajnim për politika publike në ATRC	4
Këshilla për shkrimin gazetaresk	5
Vazhdimi i këshillave për shkrim gazetaresk	6
Shpjegimi i dokumentacionit për trashgimi	6
Komentet dhe paralajmërimet e ICG-së	7
Vazhdimi i komenteve të ICG	8
Tryezë e rumbullakët për papunsinë ndër të rinj	8

1) Cilat mendoni se ishin sukseset më të mëdha të ATRC-së në vitin 2004? Viti 2004 ishte një vit shumë i mirë për ATRC-në. Këtë vit kemi patur mundësinë që të bëhemi më aktivë në fushatat mediale dhe në aktivizëm e jo të mbetemi vetëm ofrues shërbimesh. ATRC-ja është bërë më e fokusuar në çështje, se më parë. Suksesi më relevant ka qenë fushata Dil dhe Voto. Këtë fushatë e bashkëudhëhoqëm me Këshillin Kombëtar Demokratik (NDI) dhe Rrjetin e Grupeve të Grave të Kosovës (RRGGK), që u përfundua me sukses, pasi që gjatë zgjedhjeve votuan mbi 50 përqind e votuesëve. Gjatë kësaj kohe, ATRC-ja dhe veprimtaritë e saj, gjithashtu, u mirënjohën më mirë, siç tregojnë të gjitha regimet pozitive që kemi marrë. Sukseset tjera në vitin 2004 përfshijnë

angazhimin tonë në një fushatë të madhe kundër korrupsionit, pjesëmarrjen në koalicionin për ndryshimin e ligjit të zgjedhjeve, si dhe organizimin e "Konferencës mbi Rolin e Diasporës". 2) Pse mendoni që ATRC-ja ka pranuar kaq shumë reagime pozitive për fushatën Dil dhe Voto dhe pse e konsideroni Konferencën mbi Rolin e Diasporës si sukses të rëndësishëm? Arsyeja pse kemi marrë kaq shumë reagime pozitive më duket se qëndron në faktin që kjo fushatë ishte e



Drejtori i ATRC-se, Kreshnik Berisha në zyrat tona në Prishtinë

përqëndruar në një çështje shumë të rëndësishme, si dhe për shkak të rrjetëzimit të më shumë se 70 organizatave të ndryshme. Fushata ra në sy të shumë personave, pasi që kishte një strategji të mirë mediale dhe merrej me një çështje të

Vijon në faqe 2

Mbahet në ATRC një Trajnim për politika publike

Prishtinë, 17-19 janar. Në zyrën e ATRC-së u mbajt një trajnim tre-ditor për politika publike nga dy profesorë të Univeritetit të Shtetit të Nju Jorkut (SUNY), z. Mark Baskin dhe z. Robert T. Nakamura. Ky trajnim u

ndodh nga anëtarë të think-tank dhe instituteve si SFERA, Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Dokumentim (KODI), Grupi Ron Brown, Instituti Kosovar për Hulumtim e Zhvillimi të Politikave publike (KIPRED) dhe

Qendra për Studime Gjinore. Ky trajnim u mundësua nga mbështetja e popullit amerikan përmes USAID-it.

Shumica e pjesëmarrësve në trajnim kishin publikuar studime mbi ngjarjet e marsit të vitit 2004. Këto studime u prezantuan në zyrën e ATRC-së në tetor dhe u përcollën nga mediat vendore. Profesorët nga SUNY i rishikuan këto studime dhe e përdorën ditën e parë të trajnimit për të diskutuar procesin që kishin ndjekur pjesëmarrësit për t'i shkruar studimet e tyre. Profesorët komentuan mbi probleme specifike që mund të kenë patur

Vijon në faqe 4



Profesor Nakamura dhe Baskin duke lexuar studimet mbi ngjarjet e Marsit

Mileniumi i Ri mban një trajnim dy ditor për gazetari

Prishtinë, 28-29 janar. Një trajnim dy-ditor gazetarësh u mbajt në zyrat e ATRC-së, në të cilin morën pjesë gazetarë të rinj dhe studentë të gazetarisë. Ky trajnim ishte pjesë e projektit "Bashkë më Mirë" të OJQ-së vendore "Mileniumi i Ri". Ky projekt është financuar nga FDI-ja përmes ndihmës së popullit amerikan.

Sipas drejtorit ekzekutiv, Nehat Bllaci, Mileniumi i Ri u krijua në vitin 2001 për të fuqizuar rininë, gratë dhe pakicat. Qëllimi i këtij trajnimi është që t'i tregojnë gazetarëve të rinj se si ta bëjnë më mirë punën dhe si t'i kërkojnë llogari autoriteteve.

Trajnimi u ndoq nga më shumë se 12 gazetarë të rinj që shkruajnë për organizata të ndryshme mediatike, si elektronike edhe të shtypura. Tema e trajnimit ishte se si të shkruajnë për politika publike duke u fokusuar tek procedurat e prokurimit. Trajneri Afrim Berisha shpjegoi se si të hetohet procedura e prokurimit dhe disa rregulla të shkrimit për gazetari. ■

Intervista e fundvitit me Kreshnik Berishën (vijon nga f.1)

rëndësishme. Konferenca mbi Rolin e Diasporës ishte e rëndësishme, sepse tentonte që të gjente mënyrën për ta bërë komunitetin e diasporës më të angazhuar ndaj nevojave të shoqërisë civile në Kosovë. Konferenca i bëri OJQ-të kosovare që të mendojnë për gjetjen e financimit nga bashkëatdhetarët jashtë vendit. Ato gjithashtu mësuuan nga komunitetet më të organizuara të diasporës, siç është diaspora hebraike në SHBA.

3) Edhe pse fushata kundër korrupsionit sapo ka filluar, çfarë mendoni që do të jetë roli i ATRC-së në këtë fushatë dhe pse mendoni që kjo fushatë është kaq e rëndësishme?

Kjo fushatë [që përfshin krijimin e Koalicionit Anti-korrupsion mes qeverisë dhe shoqërisë civile] është e rëndësishme, sepse përfshirja e shoqërisë civile është shenjë e nisjes së mirë për një të ardhme, ku shoqëria civile dhe institucionet qeverisëse kanë marrëdhënie të mira në mes tyre. Ky është gjithashtu një hap frymëzues drejt njohjes së nevojës për kontributin dhe përkrahjen nga ana e sektorit joqeveritar për veprimtaritë, që shumë i shohin brenda fushëveprimit të qeverisë. Roli i ATRC-së në këtë fushatë është që të bashkëdrejtojë koalicionin; vetëdijësojë popullatën e gjerë mbi çështjet e korrupsionit; ofrojë trajnime zyrtarëve qeveritarë dhe të vendosë mekanizma ligjorë kundër praktikave të korrupsionit. ATRC-ja ka ofruar komente gjatë hartimit të planit dhe do të jetë një partner i rëndësishëm për zbatimin e fushatës. Në të ardhmen, shpresojmë se do të zhvillojmë kapacitetet monitoruese për t'i ndihmuar zyrrës së prokurorisë.

4) Si do ta përcaktojnë zhvil-

limet e këtij viti të ardhmen e ATRC-së?

Ne duhet të bëjmë ndryshime qenësore, pasi kemi filluar që të përqëndrohemi më shumë në çështjet. Ne na duhen më shumë partnerë, për t'i menaxhuar me sukses fushatat. Për ta arritur këtë, ne planifikojmë që të përkrahim AvoKo-në, rrjetin e OJQ-ve që është reformuar në tetor të vitit 2004. Dil dhe Voto na ka mësuar se si t'i organizojmë më mirë fushatat e rëndësishme, që është një aftësi qenësore për ta patur gjatë tranzicionit prej ofrimit të shërbimeve në një rol më aktiv.

Këtë vit, ne gjithashtu kemi filluar bashkëpunimin me institucionet qeverisëse përmes koalicionit kundër korrupsionit. Këtu në ATRC, ne besojmë se qeverisja e mirë dhe transparente është kyçe për zhvillimin e shoqërisë kosovare. Ne do ta vazhdojmë këtë bashkëpunim për sa kohë që partnerët tanë nga qeveria të tregojnë vullnet për ndryshime për mirë. Ne shpresojmë ta zgjerojmë këtë bashkëpunim në çështje të tjera që neve na interesojnë, si p.sh. Ligji për qasje në dokumentet zyrtare.

5) Arritjet e ATRC-së kanë qenë të mundshme vetëm përmes përkrahjes së konsiderueshme që i jepet. A do të kishit dashur të falenderoni në mënyrë më specifike ndonjë organizatë apo person?

Roli i partnerëve tanë ka qenë gjithmonë kyç, pasi që ATRC-ja nuk mund t'i arrijë të gjitha që dëshiron, pa ndihmën dhe përkrahjen e partnerëve të vet. Marrëdhëniet tona të veçanta me Fondacionin për Iniciativa Demokratike (FDI) janë në suaza të partneritetit tonë më të rëndësishëm që e kemi me ndonjë OJQ vendore.

Ka shumë organizata me të cilat bashkëpunojmë për t'u përmendur të gjitha këtu, por disa të cilat i veçojmë janë OJQ-të e AvoKo-së, RGGK-në, NDI-në, IKDO-në dhe KODI-n.

Në anën tjetër, është e qartë se veprimtaritë tona i ka bërë të mundura kontributi i popullit të SHBA-ve, përmes USAID-it. Ndikimi i USAID-it në veprimtaritë tona ka qenë qenësor. Shumë dontorë të tjerë kanë i ndihmuar gjithashtu veprimtaritë tona.

Falenderime të veçanta duhet t'i bëhen Institutit për Menaxhim Lindje-Perëndim (EWMI). Përkrahja e tyre teknike dhe strukturore ka qenë jetike për punën tonë. Besimi që ka patur EWMI në aftësitë tona na ka mundësuar që të krijojmë një OJQ njëmend vendore në pajtim me standardet ndërkombëtare. EWMI nuk ka vepruar si prind i stërbregosur, duke e mbrojtur fëmijën e vet, por na ka lejuar që ta udhëheqim vetë këtë OJQ vendore. EWMI na ka dhënë ekspertizën që na duhej, por gjithashtu na ka lejuar që të mësojmë se si t'i menaxhojmë vetë gjërat dhe të kemi qëndrueshmëri. Falenderimet e veçanta i shkojnë z. Fron Nazi, që ka qenë i pranishëm që nga themelimi i KNAP-it e deri më tani, kur tashmë ka kaluar në pozitë më të lartë.

6) A keni diçka për të shtuar?

Po, dua të them se këtë vit kemi kaluar nëpër shumë ndryshime si organizatë. Si rezultat i kësaj, ne jemi shndërruar në një partner të respektueshëm në komunitetin e OJQ-ve dhe planifikojmë që ta vazhdojmë punën tonë në ndërtimin e demokracisë. ■

Shpjegim i projektit të ATRC-së për qasjen e dokumentave shtetëror

Ligji i Kosovës mbi Qasjen në Dokumentet Zyrtare është aprovuar nga parlamenti dhe është nënshkruar nga Administratori i KB-së në nëntor të 2003. Edhe pse Neni 17.1 thotë se "Qeveria miraton rregulla dhe procedura adekuate për klasifikimin e dokumenteve të ndjeshme... gjashtëdhjetë ditë pas hyrjes në fuqi të ligjit", një gjë e tillë ende nuk është bërë as pas një viti.

Janë formuar dy grupe pune për Ligjin mbi Qasjen në Dokumentet Zyrtare. Njëri prej grupeve u themelua nga Zyra Ligjore e Kryeministrit me qëllim që të përgatisin hartimin e ligjit, ndërsa tjetri u formua nga OJQ-të ndërkomëtare dhe vendore.

Anëtarë të OJQ-ve ndërkomëtare dhe vendase nga grupi i dytë punues, siç është Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) janë duke punuar me qeverinë për hartimin e amendamentit për këtë ligj, në njërin anë, dhe mbajnë trajnime të zyrtarëve, në anën tjetër. ATRC-ja, anëtare e të dy grupeve punuese, do të punojë, përveç të tjerash, në ndërtimin e kapaciteteve të OJQ-ve Kosovare dhe do të angazhohet në vetëdijësimin e opinionit publik dhe atë të OJQ-ve lidhur me shfrytëzimin sa më frytdhënës të këtij ligji.

ATRC-ja, do të organizojë diskutime publike nëpër shumë komuna të Kosovës lidhur me Ligjin për Qasje në Dokumentet Zyrtare, në fund të kësaj pranvere. Bashkëpunimi i mirë midis anëtarëve të grupeve punuese, si dhe ura e krijuar midis tyre dhe Zyrës Ligjore të Kryeministrit, do të kontribuojnë shumë në arritjen e qëllimeve përfundimtare në të ardhmen.

ATRC-ja mban diskutim publik mbi ndotjen e ujit

Prishtinë, 26 janar. OJQ-ja vendore "Uji për milleniumin e tretë" (UMIII) bashkëpunoi me ATRC-në për të organizuar një diskutim publik rreth çështjes së ndotjes së ujit të puseve. Diskutimi u fokusua në analizimin e situatës së tanishme të ujit të puseve në Kosovë dhe prezantimin e zgjidhjeve të mundshme. Projekti i UMIII-të u financua nga Fondacioni për Iniciativa Demokratike (FDI), me mbështetjen e popullit amerikan përmes USAID-it. Edhe në numrin e dhjetorit të "Avokimit" u shkrua për këtë projekt.

Diskutimi publik u moderua nga Drejtori i ATRC-së, Kreshnik Berisha. Drejtori i UMIII-të, Halit Gashi, prezantoi studimin e organizatës së tij për pjesëmarrësit dhe u përfshi në një debat të ndezur me përfaqësuesen e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHP), zj. Burbuqe Nushi. Gjithashtu, edhe dy panelistët e tjerë nga Zyra Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), zj. Hajrie Morina dhe specialisti i ujit Mirko Manzoni, shprehën opinionet dhe komentet e tyre mbi çështjen. Specialistët për çështjet e mjedisit dhe gazetarë të KTV-së ishin gjithashtu të

pranishëm.

Përfaqësuesja e IKSHP-së u duk e pakënaqur që OJQ-të vendore nuk kishin bashkëpunuar me institutin e tyre në kryerjen e analizave. Sipas saj, vetëm IKSHP-ja e ka të drejtën që të analizojë ujrat e Kosovës. Ajo kundërshtoi përfundimet e analizës së UMIII-të, që kishte nxjerrë se të gjitha mostrat ishin të ndotura ose bakteriologjikisht ose kimikisht. Por, ajo solli të dhëna të IKSHP-së që 72% e puseve janë bakteriologjikisht të ndotura, kurse 49% kanë mbetje kimike. Sipas saj, uji nga 85% e puseve në Kosovë është i rrezikshëm. Megjithatë ajo e pranoi që të gjitha mostrat e studimit mund të kenë patur ndotje, ajo e quajti të ulët impaktin e përdorimit të këtij uji mbi shëndetin e qytetarëve.

Z. Gashi u përgjigj që IKSHP-ja nuk kishte bashkëpunuar kur e kishin kontaktuar. Ai shpjegoi që metodat e përdorura dhe



Diskutimi publik në zyrat e ATRC-se i moderuar nga Kreshnik Berisha

rezultatet kishin qënë të ngjashme me ato të IKSHP-së, institut i cili teston shumë pak puse dhe nuk publikon të dhëna të hollësishme të këtyre testeve. Pjesëmarrës të tjerë kritikuan IKSHP-në për të njëjtën arsye.

Mirko Manzoni, specialisti i ujit, tha që situata në zonat urbane është po aq serioze sa në fshatra për shkak të tubacioneve të pasigurta. "Nëqoftëse kemi studime private, unë e konsideroj si një kontribut pozitiv. Ka mungesë vëmendjeje mbi këtë çështje," tha ai.

Pas ndërhyrjeve të specialistëve të SDC-së, panelistët u pajtuan që bashkëpunimi mes OJQ-ve dhe qeverisë është i dëshirueshëm. ■

Uji i ndotur përdoret nëpër shkolla

Artikulli i mëposhtëm është marrë nga Koha Ditore. Ky është njëri nga artikujt e shumtë që janë shkruan si rezultat i studimit të OJQ-së Uji për Milleniumin e Tretë

Burim, 6 Janar. Në Saradran të Burimit 600 nxënës pijnë ujë të ndotur pusi, njoftoi të enjten drejtori Bajram Berisha.

Ai deklaroi se janë bërë analizat e ujit nga ekspertë përkatës të shoqatës "Uji për Milleniumin e tretë dhe ato kanë dale keq bakteriologjikisht. "Uji i pusit të shkollës, por edhei 12 puseve të tjera që përdoren në Fshat janë të ndotur ndaj është rekomanduar që të mos përdoret', thotë ai. Sipas tij, organet e

shkollës dhe DA-ja po bëjnë ç'është e mundur për pastrimin e këtij pusi, por megjithatë ndotja është e vështirë të eliminohet. E vetmja zgjidhje për këtë problem është ndërtimi i ujësjellsit, për të cilin mungën interesimi i banorëve që ta ndihmojnë komunën shprehet ai. ■

Tre modele të procesit të krijimit të politikave publike

Tre modele të procesit të krijimit të politikave: Konceptualizimi i vendim-marrjes.

Modeli racional: Ky është modeli i ekonomistëve - modeli i maksimalizimit të vlerës. I përgjigjet pyetjes: Si mund të marrim më shumë me sa më pak shpenzime? Kjo është një metodë që merr shumë kohë dhe që ka një plan të gjërë. Shpesh përdor analizën e shpenzimeve për përfitim.

Modeli i shtesave: Ky është një model i cili përdoret për zgjidhje të shpejta. P.sh në vend që të rishtrohet e gjithë rruga mund të mbushim gropat. Kjo është si të bësh minimumin për të zgjidhur problemin.

Modeli i shportës së mbeturinave: Kjo lloj vendim-marrjeje ndodh kur ka një mundësi për të vepruar. Kjo mundësi mund të jetë e paparashikuar, si rezultat i një krize ose mund të jetë një ngjarje e pritshme, si zgjedhjet. Zakonisht akterët që kanë përgjigjen më të mirë në atë moment përfitojnë nga kjo lloj situatë. Gjithsesi, përgjigja nuk është e thënë që t'i përgjigjet pikërisht problemit të ngritur, por mund ta përdorë këtë mundësi për të shtyrë diçka tjetër. ■

Mbahet në ATRC një Trajnim për politika publike

studimet dhe se si ata mund t'i kishin shmangur ato.

Dita e dytë e trajnimit u fokusua mbi teoritë për hulumtimet e politikave publike. Në një diskutim të strukturuar mirë profesorët shpjeguan modele të ndryshme të vendim-marrjes dhe teoritë sociale me rëndësi në këtë fushë. Ata shpjeguan tre modelet e vendim-marrjes (shih tablën 1) dhe tre teoricienët më të rëndësishëm: Harold Lasswell, Charles Lindlom dhe John Kingdon. Më pas ata diskutuan mjetet e ndryshme që mund të përdoren për të ndikuar dhe ndryshuar sjelljen e akterëve të ndryshëm (shih tablën 2).

Ditën e tretë pjesëmarrësit u fokusuan mbi atë

se si mund të përdoren analizat e politikave publike në Kosovë. Trajnerët sygjeruan që grupet e analistëve ta shikojnë me më shumë kujdes axhendën e qeverisë dhe se si mund të ndikojnë në të, duke konsideruar zgjedhjet dhe kryeministrin e ri. Ata diskutuan se si grupet që merren me analiza të politikave publike mund të ndikojnë disa nga çështjet kyçe me të cilat përballet Kosova, duke përfshirë sigurinë, shëndetësinë, edukimin dhe zhvillimin ekonomik.

Trajnuesit i nxitën analistët që të mos ngelin në diskutime mbi të cilat nuk mund të kenë ndikim. P.sh. nuk ka kuptim që të humbet kohë duke diskutuar mbi statusin ose standardet, se ato nuk

mund të ndikohen lehtë, thanë profesorët. Ata sygjeruan përqëndrim në ato çështje, si shëndeti, rrugët dhe uji. Trajnerët sygjeruan që grupet e analistëve të politikave publike të fokusohen në avokim ndaj partive që nuk janë në pushtet.

Trajnerët dhanë planin hap-pas-hapi për të zhvilluar politika publike që mund t'i lexoni më poshtë.

Strategjia e Politikave publike

- 1.Zgjidh një fushë
- 2.Gjej të dhënat
- 3.Nxirr rekomandime
- 4.Boto një studim
- 5.Bëje qeverinë që t'i përdorë rezultatet. ■

Mjetet e ndërtimi të politikave publike

Autorizimi: përdorimi i forcës, si politikat, ligji apo çdo forcë e shtetit për t'i detyruar njerëzit të sillen në një mënyrë të caktuar. N.q.s njerëzit nuk bëjnë atë që duhet të bëjnë ata dënohen.

Inkurajimi: të inkurajosh sjelljen e dëshiruar përmes shpërblimit për t'i motivuar njerëzit të bëjnë atë që ti do.

Rritja e kapacitetit: ky përdoret kur nuk dihet se si të zgjidhet një problem. P.sh. ndërkombëtarët nuk e dinë se çfarë të bëjnë për statusin e Kosovës, kështu që po punojnë për rritjen e kapacitetit vendor. Nga ana tjetër kjo blen kohë për t'i pajisur vendorët me aftësitë që do t'iu duhen në të ardhmen.

Ndryshimi i sistemit: ndërrimi i të gjitha rregullave dhe sistemit. Një shembull i ndryshimit të sistemit në Kosovë është transferimi i funksioneve vendim-marrëse në lidhje me çështjen e statusit nga OKB-ja te një grup kontakti i përbërë nga vende të ndryshme. Kjo ndodh shpesh se ka kosto të ulët dhe udhëheqësit mund t'i bëjnë ndryshimet pa e bindur më parë publikun.

Informimi: është t'i bësh njerëzit të veprojnë duke iu dhënë informacion. P.sh. mund t'i bësh njerëzit ta lënë duhanin duke iu dhënë informacion për rrezikun ndaj shëndetit në kutitë e duhanit. Ndërkombëtarët dhe OJQ-të janë shumë të interesuara në këtë medotë që quhet "ritje e vetë-dijësimit". ■

Mbahet një trajnim gazetarie për OJQ-të

Bashkim Gjergji, Dekan i Departamentit të Gazetarisë në Universitetin e Tiranës, drejtoi një trajnim dyditor për gazetarë për punonjësit e Ojq-ve dhe stafin e ATRC-së. Ky trajnim për fillestarë qartësoi se si gazetari duhet të shkruajë e të intervistojë. Ky trajnim i inkurajoi OJQ-të vendore të krijojnë kontakt direkt me organizatat e mediave për të informuar dhe promovuar aktivitetet. ATRC-ja organizoi këtë trajnim duke përdorur fonde të KNAP-it. Për të arritur të komunikojnë me një audiencë sa më të gjerë, po e botojmë këtë guide të vogël për shkrimin gazetaresk. Këtu te ATRC-ja ne i konsiderojmë aftësitë e gazetarisë të rëndësishme se kur organizatat shkruajnë vetë për median, rrisin ndjekjen e aktiviteteve të organizatës nga media. Kjo ndodh se burimet njerëzore të mediave janë të kufizuara dhe nuk mund të shkruajnë për të gjitha çështjet, problem që zgjidhet kur OJQ-të e bëjnë vetë punën e gazetarit. Kjo guidë është shkruar për nevojat e OJQ-ve dhe të interesuarve të tjerë. ■

Këshilla për shkrimin gazetaresk

Cili është ndryshimi midis shkrimit letrar dhe atij gazetaresk? Gazetaria është e lidhur me letërsinë, se të dyja përdorin gjuhën për të ndërtuar një narrativë. Por, shkrimi gazetaresk është një tjetër lloj narrative që ka rregullat e veta. Vetëm duke i respektuar këto rregulla mund të sigurohemi që po shkruajmë si gazetarë. Por, nuk është e nevojshme që shkrimi gazetaresk të jetë krejt i ndarë nga shkrimi artistik. Bile, është e nevojshme që të përfshijmë elementë të shkrimit artistik edhe në gazetari për ta bërë më interesant artikullin, për sa kohë respektojmë rregullat e gazetarisë. Për një gazetar është e nevojshme që të ketë kontroll të mirë të gjuhës dhe një fjalor të pasur, që të mund të shprehë tingujt, aromat dhe ndjenjat, për t'ia paraqitur sa më qartë ngjarjen lexuesit.

Saktësia në gazetari

Saktësia është e shumë e rëndësishme. Në mënyrë që të raportojmë saktë ngjarjet, për një gazetar është e rëndësishme që të marrë shënime të hollësishme dhe t'i regjistrojë bisedat që mund të jenë të rëndësishme për të shkruar një artikull. Kur e shkruajmë artikullin duhet që faktet dhe shënimet t'i përfshijmë me kujdes dhe ndershmëri.

Në këtë mënyrë gazetaria mund të krahasohet me shkrimin shkencor. Një gazetar, si një shkencëtar (ose profesor), merret me faktet.

Si në shkrimin shkencor, një gazetar duhet të jetë i sigurt që vërtetësia e çdo fjalie mund të provohet. Është e rëndësishme që faktet që janë baza e artikullit të jenë të sakta dhe të paraqiten sa më qartë që të jetë e mundur.

Rregullat e përmendura më lart janë të vlefshme për çdo lloj shkrimi gazetaresk, por për të shkruar një artikull të mirë duhen të paktën edhe dy rregulla të tjera. Njëra është që gazetari duhet ta njohë audiencën e vet dhe si t'ia tërheqë vëmendjen. E dyta është që gazetari duhet të vendosë se çfarë formati do të përdorë, në varësi të temës. Ka katër lloje kryesore formatesh për shkrim gazetaresk: lajme, opinion (ku përfshihen edhe editorialët), intervistë dhe analizë. Nganjëherë, një përzierje e këtyre formateve mund të gjendet në një artikull.

Shkrimi i lajmeve

Këtu do të fokusohemi mbi strukturën dhe rregullat e shkrimit të lajmeve. Një lajm duhet të jetë i qartë dhe i thjeshtë. Duhet t'i paraqesë me vërtetësi faktet. Nuk duhet të ketë karakter manipulativ ose propagandistik dhe autori nuk mund të fusë opinionet e tij personale në të. Struktura e fjalisë duhet të jetë sa më e thjeshtë.

Një lajm duhet të ketë hyrjen, përmbajtjen dhe përfundimin. Hyrja sqaron çështjen kryesore me të cilën merret artikulli si dhe faktet

ose argumentet më të rëndësishme për këtë çështje. Përmbajtja duhet të detajojë një narrativë që shpjegon të gjitha çështjet që janë prekur në hyrje. Duhet të sigurohemi që çdo artikull duhet t'i përgjigjet katër pyetjeve; çfarë, kush, ku dhe kur. Përfundimi i artikullit duhet ose të përmbledhë argumentet e mësipërme ose t'i lidhë ato me hyrjen.

Nga ana skematike, procesi i shkrimit të një lajmi mund të prezantohet nga një piramidë kokëposhtë; paragrafi i parë përfshin qëllimin e të gjithë artikullit, kurse paragrafët në vazhdim kanë fokus gjithnjë e më të ngushtë.

Problemet etike

Mbajtja e një strukture të thjeshtë fjalie i ndihmon gazetarit që t'i shpëtojë keqinterpretimeve. Një strukturë e thjeshtë fjalie parandalon gabime që dikush edhe mund t'i konsiderojë si dështime etike. Problemet etike që has një fillestar në gazetari shpesh kanë lidhje me përdorimin e burimit. N.q.s burimi keqpërdoret (gënjehet apo ka lidhje të forta personale, të padeklaruara me autorin), apo disa shprehje janë keqinterpretuar, mund t'i bëjë njerëzit të mendojnë se ka shkelje etike, edhe sikur këto të jenë thjesht gabime.

Po të ndjekim rregullat e sqaruara më sipër, nuk duhet të ketë probleme etike, sidomos kur autori e ka të qartë se çfarë marrëdhënieje

Disa këshilla për të shkruar më mirë

Përdor një strukturë të thjeshtë të fjalisë. Do të ndihmojë ta tregosh qartë ngjarjen dhe të mbash një strukturë të thjeshtë në përgjithsi.

Përdor specifika. Mos shkruaj "ishte një ngjarje e suksesshme me shumë pjesëmarrës duke mësuar dhënë gjëra". Shkruaj "më shumë se 30 pjesëmarrës morrën pjesë në trajnim ku ata mësuan të intervistojnë e shkruajnë". Mos shpall "sukses" por shpjego se pse ishte kështu.

Aftësitë për të shkruar më mire rriten vetëm duke lexuar shume e në mënyrë të hollësishme.

Kur nuk të pëlqen diçka që ke shkruar mos e korrigjo por rishkruaje.

Gjithmonë jepja punën tënde edhe dikujt tjetër për ta parë para se ta dorëzoh për botim.

Para se të fillosh të shkruash, do të ndihmojë po të mendohesh për strukturën e artikulli dhe përmbajtjen e çdo paragrafi. Ky ushtrim mund të ndihmojë shumë në afat të gjatë. ■

Këshilla për shkrimin gazetaresk (vijon nga f.5)

duhet të ketë me burimet. Dy rregullat më të rëndësishme në lidhje me burimin janë: mos i keqinterpretos burimet (përdor citatet kur ta kesh të mundur, për të fituar besimin e lexuesit dhe mos krijo lidhje shumë të ngushta me burimin.

Intervistimi

Le të merremi me intervistimin. Është e rëndësishme për një publikim që të ketë diversitet formatësh. Një intervistë mund t'i japë një dimension tjetër më tërheqës një

çështjeje që përndryshe mund të jetë e mërzitshme. Në mënyrë që të drejtojmë një intervistë të mirë është e rëndësishme të ndjekim disa rregulla. Jo vetëm që intervistuesi duhet t'i ketë pyetjet gati, por duhet të jetë i gatshëm që të bëjë pyetje edhe për përgjigjet që i jepen. Duhet ta mendoni veten si specialist mbi një çështje të caktuar vetëm për një ditë. Në intervistë paraqitja juaj duhet të jetë serioze. Është e rëndësishme që të bisedoni me sub-

jektin, para se ta nisni intervistën. Pasi e keni thyer akullin me të intervistuarin, mund të bëni pyetje më të vështira. Duhet të bëni gjithshka që është e mundur për të marrë përgjigjen e pyetjes tuaj. Biseda duhet të regjistrohet dhe duhet të merrni shënime mbi ambientin që ju rrethon, si dhe sjelljen e të intervistuarit. Është më mirë të jeni të sigurtë me subjektin dhe të mos përfitoni nga burimet duke botuar informacion konfidencial. ■

Shpjegimi i dokumentacionit për trashgimi



Nga e majta në të djathtë panelistet Ms.Mejreme Halili, Haki Lecaj dhe. Razmije Brovina, .

Prishtinë, 27 janar. Projekti për të Drejta Civile/Kosovë, organizoi një tryzë të rumbullakët në Hotel Prishtina për të prezantuar dhe debatuar mbi pengesat e mundshme ndaj marrjes së trashëgimisë. Ky projekt u financua nga FDI-ja. Qëllimi i këtij granti është të studiojë problemet me dokumentacionin që dalin në procesin e marrjes së trashëgimisë.

Një audiencë e madhe specialistësh ishin të pranishëm në këtë tryzë të

Ndërkombëtar Katolik për Migrimin, Këshilli Danez për Refugjatët, "Lëvizja për paqe, çarmatim dhe liri" nga Spanja si dhe avokatë e gjykatës vendore.

Kjo tryzë e rumbullakët u moderua nga Haki Lecaj, nga Instituti Gjyqësor i Kosovës. Ai tha se qëllimi i projektit është që të ndihmojë gjykatat, duke e kuptuar që nuk mund t'i bëhet presion sistemit gjyqësor". Dy panelistet e tjera ishin Mejreme Haliti, trajnuese

rrumbullakët, duke përfshirë specialistët nga Praxis, Komisioni

gjyqësore dhe Remzije Brovina, gjykatëse nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës.

Tryeza e rumbullakët u mor kryesisht me procedurat e dokumentimit. Gjykatësi shpjegoi procesin dhe iu përgjigj pyetjeve, si dhe mori sqarime nga specialistët e tjerë të pranishëm. Gabimet e mundshme u debatuan në hollësi në një ambient profesional që shtynte shkëmbimin e informacionit. Çështje nga praktika u sollën nga zj. Brovina duke treguar se si edhe një harrësë minimale mund ta prishë çështjen. Si përfundim i tryezës së rumbullakët, pjesëmarrësit i kupuan më mirë problemet e mundshme të dokumentimit dhe premtuan të bashkëpunojnë dhe ta shpërndajnë më mirë informacionin në të ardhmen. ■

Prishtinë 17 dhjetor. Një tryzë e rumbullakët mbi "Rinina dhe papunësia u organizuar sot në Vila Lira

Report i krizave të mundshme nga ICG

Ramush Haradinaj, udhëqësi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, u zgjodh kryeministër më 7 dhjetor, teksa pritet të thirret për krime luftarake nga Gjykata Ndërkombëtare për Krimet në ish-Yugosllavi. Megjithatë qeveria e Haradinajt ka patur një fillim shumë konfident dhe popullor, Beogradi është i tërbuar, ndërsa komuniteti ndërkombëtar i shqetësuar. Një akt-akuzë ka mundsi të ndezë një krizë serioze politike, dhe trazira në vendlindjen e Haradinajt në Kosovën perëndimore.

Edhe më shumë përgjegjësi ekonomike po i transferohen institucioneve kosovare, teksa media po fokusohet përherë e më shumë në varfërinë në rritje, dhe KEK-u po i pret rrymën shumë fshatrave (të banuara kryesisht nga shqiptarë) që nuk paguajnë. Qeveria serbe refuzoi të merrej me Haradinajn apo me decentralizimin sipas kushteve të UNMIK-ut. Zyrtarët e Beogradit dhe media treguan një axhendë provokuese: bënë lëvizje trupash në rajonet e banuara nga shqiptarë në jugun e Serbisë, ngjitur me Kosovën; keqinterpretu prerjen e rrymës nga KEK-u për fshatrat serbe si diskriminim etnik; mbështeti kërcënimet për bllokimin e autostradës që nxiti aktet e dhunës nga shqiptarët në mars 2004.

Report i ICG-së për Kosovën

Prishtinë, 24 janar. Në një prezantim në Grand Hotel Prishtina, Grupi Ndërkombëtar i Krizave prezantoi raportin e fundit mbi Kosovën. Ky raport erdhi pas paralajmërimit për mundësi krize që u lëshua në janar. Ky raport ka interes të veçantë për shoqërinë civile, sepse përshkruan rolin që duhet të luajë shoqëria në bisedimet për statusin përfundimtar.

Sipas këtij raporti, shoqëria civile duhet të konsiderohet një aleat i aftë në përmirësimin e

marrëdhënieve etnike. Ky është standarti më i rëndësishëm që duhet adresuar përpara diskutimeve përfundimtare. Sipas raportit, shoqëria civile duhet të përgatitet për të ulur tensionet etnike në rast krize.

Çështja e dytë madhore është përfshirja e shoqërisë civile. Disa nga komentet e raportit po i ribotojmë.

Për më tepër, pa disa garanci dhe rregulla bazë, themelet për institucionet demokratike nuk janë

stabile -në Kosovë arena sociale është në një luftë me xhirim të ngadalësuar, jo një mjedis që shtyn ndërtimin e paqes. Sa më pak që ta ngrëjë zërin bashkësia ndërkombëtare rreth çështjes së statusit përfundimtar, aq më të ngurosurat do të jenë partitë politike në vizione kundërshtuese të së ardhmes së Kosovës. Shqiptarët e Kosovës nuk kanë nxjerrë udhëheqës politikë të aftë që t'i bashkojnë rreth një vizioni për transformim.

Vijon në faqe 8

Studim i sistemit bankar



Ky poster është pjesë e programit për rritjen e vetëdijësimin

Prizren, 16 janar. Që nga tetori 2004, Klubi i Afaristëve të Prizrenit ka qënë duke studiuar sistemin e pagesave bankare. Ky projekt u mundësua nga FDI-ja me mbështetjen e popullit amerikan përmes

USAID-it.

Sipas z. Ymer Berisha, koordinatori i projektit, ka nevojë të madhe për këtë studim, sepse pagesat e mëdha shpesh duan më shumë se një muaj të kaluar në llogari, në vend të ditëve. Ky studim po bëhet për të gjetur arsyen e këtyre vonesave. "Është ose banka, ose thesari, ose thjesht keqmenaxhimi nga ana e burokracisë," tha Berisha.

Për këtë studim, Klubi po bashkëpunon me

organizata private dhe qeveritare që janë pjesë e këtyre transaksioneve. Ata po përpiqen edhe për të rritur vetëdijen e publikut ndaj kësaj çështjeje që deri tani është injoruar, duke përdorur median dhe posterat. Ky projekt do të mbarojë në mars. Diskutime publike për këtë çështje do të ketë këtu në zyrën e ATRC-së, por edhe në vende të tjera, në fund të marsit. Më pas, rezultatet e studimit do të botohen dhe prezantohen në një konferencë për shtyp.

Projekti është ende në fazat fillestare, në mbledhjen e të dhënave dhe kontaktimit me specialistë të kësaj fushe. N.q.s keni komente ose dëshironi që të merrni pjesë në diskutimin e marsit, mund të kontaktoni ATRC-në për më shumë informacion.

Report i ICG-së për Kosovën (vijon nga f.7)

Në mënyrë të gjërë shoqëria shikon mbropa, duke e parë të ardhmen përmes ankesave për padrejtësi të së kaluarës dhe frikave të tanishme për siguri, në vend që të veprojë me një frymë konstruktive ndaj pakicës serbe, Beogradit dhe shteteve fqinje. Gjithsesi, një grup i vogël por në rritje organizatash jo-qeveritare, duke përfshirë disa grupe për të drejtat e grave, po tentojnë që të krijojnë një vizion më të gjerë multi-etnik.

Krijimi i një komiteti për statusin përfundimtar - në parlament ka mundësi - mund ta zbusë përplasjen poz-

itë/opozitë që Kosova s'e ka provuar kurrë më parë. Komiteti duhet të përfshijë ekspertë nga shoqëria civile, sidomos nga pakicat më të anashkaluara, gratë dhe rinia. Mund të transformohet në mjetin e Kosovës për të prodhuar bashkim rreth një strategjie për statusin përfundimtar. Pasi të formohet, duhet të kërkojnë fondet e donatorëve për ta pajisur komitetin me një sekretariat dhe t'i krijojnë kapacitetin për të marrë në punë ekspertë të huaj të diplomacisë dhe ligjit ndërkombëtar, dhe ndoshta për të mbajtur zyra në Nju Jork dhe Bruksel. Kjo

do të hapë rrugën për anashkalimin e kufizimeve të OKB-së dhe Grupit të Kontaktit që i ndalojnë IPVQ-të që të merren me marrëdhënie ndërkombëtare.

IPVQ-të, udhëheqësit politikë dhe shoqëria civile duhet të marrin përgjegjësi dhe të fillojnë hapa konkretë për ndërtimin e bazave të një shoqërie të moralshme që tejkalon ndarjen etnike.

Shoqëria civile dhe rrjetet politike duhet të jenë të përgatitur për të kundërvepruar me akte simbolike dhe demonstrime publike, kur ndodhin sulme që dyshtojnë të jenë me motivim etnik. ■

Tryezë e rumbullakët për papunësinë e rinisë

në Gërmenj nga OJQ-ja Prishtina REA. Kjo tryezë e rumbullakët ishte pjesë e një projekti të financuar nga FDI-ja me fonde të dhuruara nga populli amerikan përmes USAID-it. Tridhjetë e gjashtë organizata vendore dh endërkombëtare si dhe zyrtarë qeveritarë morën pjesë në këtë takim. Si u përshkrua në numrin e dhjetorit 2004 të "Avokimi"-t, ky projekt ishte një përgjigje ndaj ngjarjeve të marsit 2004. Qëllimi i këtij takimi ishte të diskutonte impaktin në shoqërinë Kosovare të papunësisë ndër të rinj.

Pjesëmarrësit në këtë tryezë sollën perspektiva të ndryshme me presantimet e tyre. Folësi i parë ishte zt Ken Yamashita, drejtori i Misionit të USAID në Kosovë. Ai vuri në dukje faktin që institucionet dhe shoqëria civile kosovare nuk i kushtojnë shumë vëmendje rinisë.

Ahmet Jetullahu Drejtori i Prishtina REA, përmbodhi qëllimet e kësaj tryeze:

1) Të diskutojë çështje sensitive që mund ta çojnë popullsinë drejt ndërmarrjes së veprimeve jo-demokratike.
2) Dikutinim e krijimit të një rrjeti përfaqësuesish të shoqërisë civile, qeversë së Kosovës dhe UNMIK-ut. Ky trup duhet edhe t'i këshillojë këto organizata.

Shumë folësit vazhduan, ndër ta edhe zt. Bashkim Rrahmani, drejtor i Fondacionit për Iniciativa Demokratike, i cili dha një paraqitje të aktiviteteve të KNAP-it në lidhje me këtë çështje. Folës të tjerë nga institucionet qeveritare u fokusuan mbi punën e dikasterit të tyre. Zoti Skender Boshtarakaj, Drejtor i Departamentit të Rinisë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe çështjeve jo-Residenciale, u morr me problem të cilat trajton ky departament, si mungesa e koordinimit për çështjet e rinisë mes qeverisë, ministrive dhe organizatave donatore.

Në përfundim foli zt Winsor Lewis i cili presantoi

Fondin Pilot për Promovimin e Nënpunësimit dhe "Fondin e Princit", përgjigjja angleze ndaj një krize të ngjashme papunësie. Pas presantimeve vijoi një debat që nxorri përfundimet e mëposhtëme:

Përgjegjësia për edukim duhet të rritet nga të gjithë aktorët dhe të interesuarit, Koordinimi duhet të promovohet përmes mekanizmeve të duhur nën udhëheqjen e organeve qeveritare.shpërndarja e informacionit dhe negociatat për projekte të ndryshme duhet të bëhet një proces izaknshëm.

Përfaqësuesit e rinisë dhe të papunëve duhet të jenë aktivë në të gjitha proceset. Rinia duhet të përfshihet në të gjithë proceset sociale, Të gjitha institucionet duhet të përfshihen në Planin e Aksionit për Rininë.

Tryeza të rumbullakta mbi rininë dhe papunësinë duhet të mbahen edhe në të ardhmen. ■

Rr: Agim Ramadani, Nr. 15
(ish Ramiz Sadiku)
Kati i dytë
Prishtinë, Kosovë

Tel.: +381 38 244 810

Fax: +381 38 244 810

Email: info@advocacy-center.org

Drejtor

KRESHNIK BERISHA
keka@advocacy-center.org

Menaxhere e Përgjithshme

KIMETE KLENJA
kimete@advocacy-center.org

Menaxhere e Trajnimeve
NATYRA ZHJEQI
natyra@advocacy-center.org

Këshilltare

NICOLE FARNSWORTH
nicole@advocacy-center.org

Përgjegjës për Informim
dhe Marrëdhënie me Publik

OERD IMAMI
oerd@advocacy-center.org

Administrator Zyre GANI ASLLANI

gani@advocacy-center.org

Fondacioni për Iniciativa Demokratike është partneri kryesor zbatues i Projektit për Avokim të OJQ-ve Kosovare, i cili është një bashkëpunim i Institutit për Menaxhim Lindje-Perëndim (EWMI) dhe USAID-it, i mundësuar nga fondet e popullit amerikan.